

Politika e Privatësisë

Përshkrime të përgjithshme

- Të dhëna personale** – çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“Subjekti i të Dhënave”); person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht nëpërmjet një identifikuesi si emri, numri i identifikimit, të dhënat e vendndodhjes, identifikuesi online ose një apo më shumë faktorëve specifikë të identitetit fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Ligji** – Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27 prill 2016, “Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, si dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC
- Përpunimi i të dhënave** – çdo veprim ose grup veprimesh që kryhen mbi të dhënat personale ose mbi grupe të të dhënave personale, me ose pa mjete automatike, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, shpërndarja nëpërmjet transmetimit, publikimi ose vënia në dispozicion në çdo mënyrë tjetër, harmonizimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.
- Përpunuesi i të Dhënave** – çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që përpunon të dhënat personale në emër dhe sipas udhëzimeve të Kontrolluesit të të Dhënave, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Kontrolluesi i të Dhënave**- entiteti që përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale është Paysera Albania SHPK, që menaxhon shërbimin e iniciimit të pagesës dhe informacionit të llogarisë, identifikimin e kualifikuar elektronik dhe shërbime të tjera. Të dhënat e kontaktit të Paysera Albania janë publikuar në faqen e internetit të Paysera www.paysera.al Paysera Albania SHPK nipt M01608007N -me seli ne Rr.“Fadil Rada”, P. Donika, K.3,Tiranë, Shqipëri. Të dhënat e kontaktit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave të emëruar nga Paysera janë: dpo@paysera.al.
- Kontrolluesi i Përbashkët i të Dhënave** , Kontrolluesi juaj i të dhënave personale është rrjeti Paysera. Sipas [Marrëveshjes së Bashkëkontrolluesit](#) Nr. 2018019 të datës 19/09/2018, Paysera Albania së bashku me kompanitë e tjera të rrjetit dhe me koordinatoren Paysera Tech, vepron si Bashkëkontrollues në përputhje me Shtojcën Nr. 16 "**Marrëveshja e Rrjetit mbi Qeverisjen e të Dhënave**" të Marrëveshjes së Aktivitetit të Përbashkët. Kjo marrëveshje rregullon ndarjen e përgjegjësisë dhe siguron mbrojtjen e të dhënave brenda rrjetit. Të dhënat personale përpunohen bashkërisht vetëm për të siguruar sigurinë e rrjetit dhe integritetin operacional, konkretisht: për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; për zbulimin e mashtrimit; për menaxhimin e incidenteve të sigurisë; dhe për të siguruar mbështetje të pandërprerë të klientit kur shërbimet ofrohen nga një partner tjetër i rrjetit.

7. **Subjekti i të Dhënave ose Klienti** – një person fizik që synon të hyjë, ose ka hyrë, në një marrëdhënie biznesi me Kontrolluesin e të Dhënave (p.sh., krijimi i profilit, hapja e një llogarie pagese, marrja e një mjeti të kualifikuar identifikimi elektronik, lidhja e një marrëveshjeje për ofrimin e shërbimit me Kompaninë, etj.), ose marrëdhënia e biznesit të të cilit ka përfunduar, por të dhënat e të cilit përpunohen ende nga Kontrolluesi i të Dhënave në përputhje me dispozitat ligjore.
8. **Platforma** – një zgjidhje softuerike e hostuar në faqet e internetit që i përkasin Kompanisë, e zhvilluar nga Kompania dhe e përdorur për të ofruar shërbimet e Kompanisë.

Dispozitat e Përgjithshme

9. Të dhënat personale të mbledhura nga Paysera përpunohen në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i Republikës së Shqipërisë, GDPR si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Të gjithë personat, përfaqësuesit dhe punonjësit e përfaqësuesve që veprojnë në emër të Paysera të cilët kanë aftësinë për të aksesuar sistemet me të dhënat e Klientit, i aksesojnë ato ekskluzivisht për kryerjen e funksioneve të tyre të punës, duke pasur një bazë legjitime për një akses të tillë, dhe duhet t'i mbajnë të dhënat personale të njohura gjatë punës konfidenciale edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës ose kontraktuale.
10. Kompania, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, do të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave personale dhe zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga aksesit i paautorizuar, zbulimi, humbja aksidentale, alterimi, shkatërrimi ose përpunimi tjetër i paligjshëm.
11. Kjo Politikë Privatësie përcakton rregullat bazë për mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe mbajtjen e të dhënave tuaja personale, informacioneve të tjera që lidhen me ju, fushëveprimin, qëllimin, burimet, marrësit dhe aspekte të tjera të rëndësishme të përpunimit të të dhënave tuaja personale kur përdorni Paysera si ofrues të shërbimit të pagesave. Në këtë Politikë Privatësie, termat e përdorur në formën e njëjësit përfshijnë edhe formën e shumësit, dhe termat e përdorur në formën e shumësit përfshijnë edhe formën e njëjësit, përveç nëse konteksti tregon qartë ndryshe.
12. Duke aksesuar faqen e internetit të Paysera dhe/ose duke përdorur aplikacionin, dhe/ose informacionin që përmbahet aty, dhe/ose shërbimet, ju pranoni dhe konfirmoni se keni lexuar, kuptuar dhe jeni dakord me këtë Politikë Privatësie. Gjithashtu, pasi të regjistrohemi në sistem dhe të filloni të përdorni shërbimet e Paysera, kjo Politikë Privatësie bëhet një Shtojcë e Marrëveshjes së Përgjithshme të Shërbimeve të Pagesave.
13. Paysera rezervon të drejtën, sipas gjykimit të saj ekskluziv, të modifikojë këtë Politikë Privatësie në çdo kohë duke publikuar një version të përditësuar të Politikës së Privatësisë në faqen e internetit dhe, nëse ndryshimet janë substanciale, duke njoftuar përdoruesit e regjistruar me email ose njoftim brenda aplikacionit. Një version i ndryshuar ose i përditësuar i kësaj Politike Privatësie do të hyjë në fuqi pas publikimit të tij në faqen e internetit.
14. Nëse përdoruesi i shërbimeve është një klient biznesi, kjo Politikë Privatësie zbatohet edhe për personat fizikë, të dhënat personale të të cilëve i transferohen Paysera-s nga klienti biznes, përfshirë administratorët, ortakët, përfaqësuesit ligjorë, punonjësit, përfituesit përfundimtarë, agjentët ose persona të tjerë të lidhur me klientin biznes. Klienti biznes merr përsipër të informojë këto Subjekte të të Dhënave për transferimin dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale nga Paysera, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Nenin 14 të GDPR.

Qëllimet e përpunimit të të dhënave, ofruesit, afatet, marrësit

15. Qëllimi kryesor për të cilin Paysera mbledh të dhënat tuaja personale është ofrimi i shërbimeve të pagesave të Paysera për klientët që dërgojnë dhe marrin pagesa. Si ofrues i pagesave, identifikimit

elektronik të kualifikuar, Paysera është e detyruar ligjërisht të përcaktojë dhe verifikojë identitetin tuaj përpara se të hyjë në transaksione të shërbimeve financiare me ju, gjithashtu, në momentin e ofrimit të shërbimeve, të kërkojë informacione të mëtejshme, si dhe të vlerësojë dhe ruajë këtë informacion për periudhën e mbajtjes të përcaktuar me ligj. Duke pasur parasysh këtë, ju duhet të jepni informacion të saktë dhe të plotë.

QËLLIMI: Identifikimi i klientit, ofrimi i pagesave (hapja e llogarisë, transfertat e fondeve, përpunimi i pagesave etj.), shërbimet e identifikimit elektronik të kualifikuar, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dorëzimi i raporteve autoriteteve shtetërore, zbatimi i detyrimeve të tjera ligjore të ofruesit të shërbimit të pagesave.

16. Të dhënat personale përpunohen për këtë qëllim në përputhje me kërkesat ligjore që lidhen me: identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit; lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve me Klientin, si dhe ndërmarrjen e masave paraprake me kërkesë të klientit përpara lidhjes së marrëveshjes, ekzekutimin e transfertave të fondeve dhe transmetimin e informacionit të nevojshëm që shoqëron transfertën në përputhje me legjislacionin në fuqi; zbatimin e kërkesave “Njih Klientin Tënd” (“Know Your Customer – KYC”); monitorimin e vazhdueshëm dhe periodik të aktivitetit të klientit; vlerësimin e riskut; përditësimin e të dhënave të Klientit për të garantuar saktësinë e tyre; parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, parandalimin e mashtrimit, zbulimin, hetimin dhe raportimin e aktiviteteve të tilla; identifikimin e personave të ekspozuar politikisht (PEP) ose të sanksioneve financiare të vendosura ndaj klientit; si dhe garantimin e menaxhimit të duhur të riskut dhe organizimit të brendshëm.
17. **Për këtë qëllim, mund të përpunohen të dhënat personale vijuese:** emri, mbiemri, gjinia, numri personal i identifikimit, data e lindjes, një foto e fytyrës, regjistrimi i transmetimit të drejtpërdrejtë video (transmetimi i drejtpërdrejtë video), shtetësia, vendi i lindjes, vendi i banimit, të dhënat nga një dokument identiteti (duke përfshirë por pa u kufizuar në një kopje të dokumentit), adresa, adresa e email-it, numri i telefonit, numri aktual i llogarisë së pagesës, adresa IP, aktiviteti aktual profesional ose i punës, funksioni aktual publik, të dhënat mbi pjesëmarrjen e klientit në aktivitete politike, përfshirja në listat e sanksioneve, të dhëna të tjera të kërkuara nga ligjet në fuqi kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të dhënat e vendndodhjes së Klientit, shërbimi i planifikuar, qëllimi i përdorimit të llogarisë (personale/biznesi), shuma e planifikuar e investimit, të ardhurat e marra, burimi kryesor i fondeve, origjina e fondeve, pronari përfitues, informacioni rreth pronarit përfitues të fundit: emri, mbiemri, shtetësia, numri i identifikimit personal (numri i ID-së kombëtare), data e lindjes, adresa, baza e autorizimit, përfshirja politike, të dhëna të tjera të specifikuara në pyetësin “Njih Klientin Tënd” (KYC) të klientit, korrespondenca e marrëdhënieve të biznesit me klientin, dokumentet dhe të dhënat që konfirmojnë operacionin ose transaksionin monetar, ose dokumente dhe të dhëna të tjera ligjërisht të vlefshme që lidhen me ekzekutimin e operacioneve ose transaksioneve monetare, vendi i rezidencës tatimore, lidhja me EEA/BE, numri i identifikimit tatimor, pajisjet e përdorura, të dhënat që lidhen me pajisjen celulare të përdoruesit, modeli, sistemi operativ, nëse pajisja është rooted, nëse pajisja është një emulator, adresa IP, SSID Wi-Fi, MAC Wi-Fi, gjuha e sistemit të pajisjes, vendi i lëshimit të kartës SIM, operatori i kartës SIM, ID-ja pseudo-unike e pajisjes, ID-ja e Android, GSFID e Android, Android fingerprint, versioni i web-view, versioni i aplikacionit Paysera, historia e transaksioneve monetare.
18. Këto të dhëna personale mblidhen dhe përpunohen në kryerjen e funksioneve të autoritetit publik që i janë caktuar Kontrolluesit të të Dhënave, dhe në bazë të një detyrimi ligjor të vendosur ndaj ofruesit të shërbimit të pagesave, d.m.th. Ligji nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, legjislacioni për institucionet e parasë elektronike dhe institucionet financiare, Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe kërkohen me qëllim hapjen e një llogarie dhe/ose ofrimin e një shërbimi pagese.
19. Periudha e mbajtjes së të dhënave: Periudha e ruajtjes së të dhënave personale është 10 (dhjetë) vjet pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit me klientin. Të dhënat personale ruhen për 5 (pesë) vjet në përputhje me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të

terrorizmit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Pas përfundimit të kësaj periudhe, të dhënat mund të ruhen për një periudhë shtesë, kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave legjitime të Paysera-s, për ushtrimin ose mbrojtjen e të drejtave ligjore, si dhe në përputhje me afatet e parashkrimit të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

20. Ofruesit dhe burimet e të dhënave personale:

21. Subjekti i të Dhënave, drejtpërdrejt;

21.1 Palë të treta, përfshirë por pa u kufizuar në:

21.1.1. Banka, institucione financiare, institucione të pagesave, institucione të parasë elektronike dhe degët ose partnerët e tyre;

21.1.2. Regjistra publikë dhe privatë, databaza shtetërore ose tregtare;

21.1.3. Databaza për verifikimin e dokumenteve të identifikimit dhe autenticitetit të tyre, përfshirë databaza ndërkombëtare të dokumenteve të humbura, të vjedhura ose të skaduara;

21.1.4. Regjistra dhe databaza të autorizimeve, përfaqësimit ligjor, prokurave ose verifikimeve noteriale;

21.1.5. Regjistra publikë që përmbajnë të dhëna mbi kufizimet e zotësisë për të vepruar ose masa të tjera ligjore të zbatueshme ndaj personave fizikë;

21.1.6. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe databaza të tjera shtetërore ose private të lejuara nga legjislacioni në fuqi;

21.1.7. Subjekte që ofrojnë shërbime të informacionit kreditor, vlerësimit të riskut ose administrimit të historikut të detyrimeve financiare;

21.1.8. Subjekte që administrojnë ose ofrojnë akses në databaza të sanksioneve ndërkombëtare, listave të personave të ekspozuar politikisht (PEP) dhe listave të monitorimit;

21.1.9. Autoritete ligjzbatuese, autoritete mbikëqyrëse, organe publike dhe institucione kompetente;

21.1.10. Përmbarues gjyqësorë dhe autoritete të ekzekutimit të detyrimeve;

21.1.11. Persona juridikë me të cilët Subjekti i të Dhënave ka lidhje si përfaqësues ligjor, punonjës, ortak, aksionar, administrator, kontraktor ose përfitues përfundimtar;

21.1.12. Partnerë tregtarë, ofrues shërbimesh ose persona të tjerë juridikë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve;

21.1.13. Rrjete sociale ose platforma elektronike, kur Subjekti i të Dhënave zgjedh të lidhë profilin e tij me sistemet ose shërbimet tona;

21.1.14. Burime të tjera të ligjshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe GDPR.

22. Me qëllim përmbushjen më efektive të detyrimeve tona ligjore – për shembull, për të identifikuar transaksione financiare potencialisht të dyshimta për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave ose për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve të identitetit – ne mund të përdorim zgjidhje të inteligjencës artificiale (IA) (mjetet mund të trajtohen duke përdorur të dhënat ekzistuese ose të dhënat mund të analizohen nga mjetet). Këto mjete ndihmojnë në përpunimin e vëllimeve të mëdha të të dhënave ose/dhe identifikimin e mospërputhjeve; megjithatë, çdo vendim përfundimtar që mund të ketë ose jo pasoja domethënëse për ju, shqyrtohet dhe miratohet gjithmonë nga punonjësit tanë.

23. Grupet e marrësve të të dhënave: autoritetet mbikëqyrëse, banka, institucione financiare, institucione të pagesave, institucione të parasë elektronike dhe degët ose partnerët e tyre, Organet e hetimit paraprak dhe të ndjekjes penale, përfshirë Policinë e Shtetit, Prokurorinë dhe autoritetet e tjera

ligjzbatuese kompetente, si dhe Administrata Tatimore Shqiptare (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe strukturat e saj vartëse), në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, përfaqësuesit e shërbimit të pagesave ose partnerët e Paysera-s (nëse transaksioni kryhet duke përdorur shërbimet e tyre), marrësit e fondeve të transaksionit që marrin informacionin në deklaratat e pagesës së bashku me fondet e transaksionit, ofruesit e shërbimeve të pagesave të marrësit dhe korrespondentët, pjesëmarrësit dhe/ose palët e lidhura me sistemet e pagesave kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, Shoqëritë e administrimit dhe arkëtimit të detyrimeve (debt collection agencies), përfshirë çdo shoqëri të licencuar ose të autorizuar sipas legjislacionit shqiptar për kryerjen e shërbimeve të administrimit, rikuperimit dhe arkëtimit të detyrimeve financiare, si dhe shoqëritë ose subjektet që përpunojnë dhe administrojnë të dhëna mbi historikun kreditor dhe detyrimet financiare të subjekteve (shoqëritë e informacionit kreditor), në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, avokatët, përmbaruesit, auditorët, entitete të tjera që kanë një interes legjitim, persona të tjerë sipas një marrëveshjeje me Paysera-n ose mbi baza të tjera ligjore.

QËLLIMI: Menaxhimi i mosmarrëveshjeve dhe detyrime.

24. Të dhënat personale, për këtë qëllim, përpunohen me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, menaxhimit dhe mbledhjes së detyrimeve, paraqitjes dhe/ose mbrojtjes së pretendimeve, kërkesave, padive dhe procedurave të tjera ligjore apo administrative.
25. Për këtë qëllim mund të përpunohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: emri, mbiemri, numri personal i identifikimit, adresa e banimit dhe/ose e korrespondencës, data e lindjes, të dhëna nga dokumenti i identitetit, adresa e email-it, numri i telefonit, numri i llogarisë bankare, adresa IP, ekstraktet dhe deklaratat e llogarive bankare, regjistrimet audio dhe video, si dhe çdo e dhënë tjetër personale që lidhet drejtpërdrejt me rrethanat e krijimit të mosmarrëveshjes ose detyrimit financiar.
26. Periudha e ruajtjes së të dhënave personale: të dhënat ruhen deri në përfundimin e afatit të parashkrimit të detyrimit përkatës, i cili në rastin e kërkesave financiare është 10 (dhjetë) vite nga data kur detyrimi është bërë i kërkueshëm (në rast të detyrimeve të ndara, nga data e kërkueshmërisë së detyrimit të fundit). Në rast të fillimit të procedurave gjyqësore apo përmbarimore, të dhënat ruhen deri në përfundimin e plotë të këtyre procedurave dhe përmbushjen e plotë të detyrimeve midis palëve, por jo më pak se afati ligjor i parashkrimit. Afatet e ruajtjes bazohen në dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për parashkrimin e kërkesave.
27. Burimet e të dhënave: subjekti i të dhënave (drejtpërdrejt), institucionet financiare, bankare dhe të pagesave, institucionet publike dhe regjistrat shtetërorë dhe/ose privatë, shoqëritë që administrojnë dhe përpunojnë regjistra të debitorëve dhe vlerësimit të kredive, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe çdo burim tjetër i ligjshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar.
28. Kategoritë e marrësve të të dhënave: institucionet financiare dhe të pagesave, bankat, shoqëritë e administrimit të kredive dhe/ose të vlerësimit të riskut kreditor, avokatët, përmbaruesit privatë, gjykatat dhe organet e tjera të sistemit të drejtësisë, organet hetimore dhe autoritetet tatimore, si dhe shoqëritë e mbledhjes së detyrimeve dhe çdo palë tjetër që ka interes të ligjshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar.
29. Ju lutemi vini re se në rast se keni detyrime të papaguara ndaj shoqërisë dhe vononi përmbushjen e tyre, shoqëria ka të drejtë, në përputhje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin civil dhe financiar në fuqi, të ndajë të dhëna të caktuara identifikuese dhe financiare (si të dhënat e identitetit, të kontaktit dhe informacionin mbi detyrimet financiare dhe historikun e pagesave) me shoqëri që administrojnë bazat e të dhënave të kredive dhe debitorëve, si dhe me shoqëri të licencuara për mbledhjen e detyrimeve. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të aksesojë informacionin e tij të kreditit përmes këtyre shoqërive në përputhje me procedurat e tyre të brendshme dhe ligjin në fuqi.

QËLLIMI: Mbështetja dhe administrimi i marrëdhënieve me klientët, informimi i klientëve rreth shërbimeve ekzistuese dhe të reja, ofrimi i shërbimeve, parandalimi i mosmarrëveshjeve dhe mbledhja e provave (regjistrimi i bisedave telefonike), korrespondenca e marrëdhënieve të biznesit

me Klientin.

30. Të dhënat personale përpunohen për këtë qëllim me qëllim që: të mirëmbahet marrëdhënia e biznesit dhe komunikimi me Klientin; t'i ofrohen shërbime klientit; të mbrohen interesat e Klientit dhe/ose Paysera-s; të parandalohen mosmarrëveshjet, të sigurohen prova të komunikimit të biznesit me Klientin (regjistrimet e bisedave, korrespondenca); të kryhet vlerësimi i cilësisë dhe të sigurohet cilësia e shërbimeve të ofruara nga Paysera; ku është e nevojshme për ekzekutimin e marrëveshjes, me qëllim marrjen e hapave me kërkesë të Klientit, ose në zbatimin e një detyrimi ligjor; të informohet Klienti rreth shërbimeve të ofruara nga Paysera, çmimeve të tyre, specifikave, ndryshimeve në kontratat e lidhura me Klientin, etj.; të dërgohen njoftime sistematike të Paysera-s dhe njoftime të tjera që lidhen me shërbimet e ofruara.
31. Për këtë qëllim, mund të përpunohen të dhënat personale vijuese: emri, mbiemri, adresa, data e lindjes, adresa e email-it, numri i telefonit, adresa IP, të dhënat e vendndodhjes së Klientit, deklaratat e llogarisë rrjedhëse, regjistrimet e bisedave telefonike, korrespondenca me Klientin dhe çdo të dhënë tjetër e nevojshme për qëllimin.
32. Periudha e ruajtjes së të dhënave personale është 10 (dhjetë) vjet pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit me klientin. Të dhënat personale ruhen për 5 (pesë) vjet në përputhje me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Pas përfundimit të kësaj periudhe, të dhënat mund të ruhen për një periudhë shtesë, kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave legjitime të Paysera-s, për ushtrimin ose mbrojtjen e të drejtave ligjore, si dhe në përputhje me afatet e parashkrimit të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
33. Ofruesit e të dhënave: subjekti i të dhënave drejtpërdrejt, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.
34. Marrësit e të dhënave: Autoritete ligjzbatuese, autoritete mbikëqyrëse, organe publike dhe institucione kompetente, avokatët, përmbaruesit, agjencitë e mbledhjes dhe arkëtimit të detyrimeve, entitete të tjera që kanë një interes legjitim, entitete të tjera sipas një marrëveshjeje me Paysera-n.
35. Subjekti i të Dhënave konfirmon se e kupton që njoftime të tilla informuese janë të nevojshme për përmbushjen e Marrëveshjes së Përgjithshme të Shërbimeve të Pagesave dhe/ose shtojcave të saj të lidhura me Klientin, dhe nuk përbëjnë mesazhe të marketingut të drejtpërdrejtë.

QËLLIMI: Ofrimi i shërbimeve përmes palëve të treta.

36. Të dhënat personale për këtë qëllim përpunohen me qëllim që të sigurohet gama më e gjerë e mundshme e shërbimeve të marra nga klientët e Paysera-s, me shërbime të caktuara që ofrohen nga palët e treta.
37. Për këtë qëllim, mund të përpunohen të dhënat personale vijuese: emri, mbiemri, shtetësia, numri personal i identifikimit, adresa, informacioni i kontaktit.
 1. Klienti informohet qartë për çdo përpunim të të dhënave me qëllim ofrimin e shërbimeve përmes palëve të treta, dhe të dhënat përpunohen vetëm me pëlqimin e shprehur të Klientit.
 2. Periudha e mbajtjes së të dhënave: 1 (një) vit.
 3. Ofruesit e të dhënave: subjekti i të dhënave drejtpërdrejt, Paysera, palët e treta që ofrojnë shërbime.
 4. Marrësit e të dhënave: palët e treta që ofrojnë shërbime, Paysera, Subjekti i të Dhënave.

QËLLIMI: Mbrojtja dhe ruajtja e interesave të Paysera-s dhe Klientit (vëzhgimi me video në ambientet e Paysera-s).

42. Të dhënat personale përpunohen për këtë qëllim në bazë të interesave legjitimë sipas ligjit 124/2024. Këto interesa përfshijnë sigurimin duke përfshirë mbrojtjen e shëndetit, jetës dhe pronës së punonjësve, si dhe garantimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të mbrojtur, Klientëve dhe vizitorëve të tjerë nga veprime të paligjshme si vjedhja, vandalizmi ose sulmet fizike), mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë (mbledhjen e provave objektive për hetimin e incidenteve, aksidenteve ose situatave të diskutueshme), dhe sigurimin e saktësisë dhe

transparencës së shërbimeve.

43. Për këtë qëllim, mund të përpunohen të dhënat personale vijuese: regjistrimet video në ambientet e menaxhuara nga Paysera.
44. Vëzhgimi me video kryhet në një vend të limituar të ambienteve të Paysera-s, duke përfshirë vetëm zonën e hyrjes në zyrën e Paysera, me qëllim që të sigurohet rendi i brendshëm dhe siguria e pronës. Përpara se të hyni në ambientet e Paysera-s ku kryhet vëzhgim video, ju jeni të informuar rreth vëzhgimit me shenja të veçanta.
45. Regjistrimet video në hyrje të zyrës së Paysera ruhet 72 ore. Kjo periudhë e mbajtjes është e nevojshme për të siguruar aftësinë për të zbuluar dhe hetuar incidente brenda një afati kohor të arsyeshëm, për të zgjidhur mosmarrëveshje urgjente dhe për t'u pajtuar me kërkesat e zbatimit të ligjit për të dhënat. Pas kësaj periudhe, të dhënat fshihen, përveç nëse ato kërkohen për një hetim në vazhdim, zgjidhje mosmarrëveshjeje, ose raste të tjera të parashikuara me ligj – rast në të cilin ato mbahen për aq kohë sa është e nevojshme për të arritur këto qëllime.
46. Ofruesit e të dhënave: subjekti i të dhënave drejtpërdrejt i cili viziton ambientet e Paysera-s ku kryhet vëzhgim video dhe kapet nga kamera e vëzhgimit.
47. Marrësit e të dhënave: regjistrimet video trajtohet si konfidenciale. Aksesit në to është rreptësisht i kufizuar dhe u jepet vetëm punonjësve që u kërkohet për të kryer funksionet e tyre të punës (parimi "need-to-know") dhe vetëm për qëllimet e përshkruara më sipër. Regjistrimet mund t'u jepen gjithashtu gjykatave, organet e hetimit paraprak dhe të ndjekjes penale (Policia e Shtetit, Prokuroria dhe autoritetet e tjera kompetente ligjzbatuese. Rishikimi i brendshëm i regjistrimeve kryhet vetëm kur ka një nevojë të qartë – për shembull, kur hetohet një incident, zgjidhet një mosmarrëveshje, etj.

QËLLIMI: Marketingu i drejtpërdrejtë.

48. Për këtë qëllim, të dhënat personale përpunohen me qëllim që t'u ofrohen klientëve oferta mbi shërbimet e ofruara nga Paysera dhe të merren mendimet e klientëve mbi shërbimet e lartpërmendura.
49. Të dhënat personale vijuese mund të përpunohen për këtë qëllim: emri, mbiemri, adresa e email-it dhe numri i telefonit.
